

AKT THEMELIMI

I

SHOQËRISË “WESTERN BALKANS UNIVERSITY DENTAL INSTITUTE ” SHPK

Në Tiranë, sot më 05.03.2025 (dy mijë e njëzet e pesë), **Shoqëria “WESTERN BALKANS UNIVERSITY” SHPK**, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) me numër unik të identifikimit të subjektit (NUIS) M02313010F, me seli në Tiranë, me adresë: Kashar, Autostrada Tiranë - Durrës, Km.7, pasuria nr.1184/1, zona kadastrale 2105, vol.22, fq.60, e përfaqësuar nga **Administratori Z. Ferdinand Gjana**, vendosi të themelojë shoqërinë “WESTERN BALKANS UNIVERSITY DENTAL INSTITUTE” SHPK, në cilësinë e ortakut të vetëm themelues të saj.

Bazuar në nenet 6 e vijues të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar), nënshkruhet ky Akt Themelimi, në të cilin Ortaku i Vetëm Themelues shpreh vullnetin të themelojë shoqërinë tregtare “WESTERN BALKANS UNIVERSITY DENTAL INSTITUTE” SHPK, me kushtet si vijon:

NENI 1

Emri i shoqërisë

- 1.1. Emri i shoqërisë do të jetë “WESTERN BALKANS UNIVERSITY DENTAL INSTITUTE” SHPK.
- 1.2. Ortaku i vetëm themelues i shoqërisë gëzon përgjegjësi të kufizuara deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

NENI 2

Forma e shoqërisë

- 2.1. Forma e shoqërisë “WESTERN BALKANS UNIVERSITY DENTAL INSTITUTE” SHPK (në vijim referuar si “Shoqëria”) do të jetë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (SHPK), sipas parashikimeve të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë



- 2.2. *tregtare*” (i ndryshuar), derisa të vendoset ndryshe për shndërrimin në një formë tjetër ligjore të parashikuar nga legjislacioni për shoqëritë tregtare.
- 2.3. Shoqëria është person juridik privat shqiptar dhe gëzon personalitet juridik nga data e regjistrimit të saj.

NENI 3

Selia e shoqërisë

- 3.1. Selia e shoqërisë ndodhet në Tiranë, Shqipëri, në adresën: *“Autostrada Tiranë-Durrës, Kilometri 1, Godina “T-Center”, Përball “Spitalit Hygea”*.
- 3.2. Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë selinë e saj në një adresë dhe/ose qytet tjetër brenda Republikës së Shqipërisë, si dhe ka të drejtë të hapë degë ose zyra përfaqësimi të saj kudo brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

NENI 4


Kohëzgjatja e Shoqërisë

- 4.1. Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit është i pakufizuar dhe fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 4.2. Ortaku i Vetëm i Shoqërisë mund të vendosë kufizimin e afatit të veprimtarisë dhe më pas zgjatjen e tij një apo disa herë, sipas një vendimi të posaçëm.

NENI 5

Objekti i veprimtarisë

- 5.1. Objekti i Veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë, por duke mos u kufizuar në të:



“Ofrimi i shërbimeve dentare. Import-eksport, tregti me shumice dhe pakicë të materialeve, pajisjeve dhe aparaturave dentare etj. Investime dhe shërbime në fushën e Mjekësisë dhe shëndetit, ngritja dhe menaxhimi i depove dentare, laboratorëve, klinikave dentare, fakulteteve dentare. Importimi dhe eksportimi i materialeve dhe aksesoreve dentare dhe mjekësore. Montimi dhe riparimi i aparaturave dhe pajisjeve mjekësore të tyre. Zirkonium, terapi, ortopedi, kirurgji, ortodonci, implantologji dhe ekzaminime, eksport, import dhe tregtim me shumicë dhe pakicë të të gjitha llojeve të materialeve dhe medikamenteve, pajisjeve. Asistencë teknike, mirëmbajtje dhe riparim të gjitha produkteve të përmendura me sipër. Laborator dentar, veprimtaritë me burime të rrezatimeve jonizuese, grafi dentare, panoramex, cefalometri, 3D, intraorale etj.”

- 5.2. Shoqëria ka të drejtë të shtojë, pakësojë apo ndryshojë objektin e veprimtarisë së saj, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi.

NENI 6


Kapitali i Shoqërisë

- 6.1. Kapitali bazë i shoqërisë është në vlerën prej ALL 100 (njëqind) Lekë, i përbërë nga 1 (një) kuotë, me vlerë nominale prej ALL 100 (njëqind) Lekë, e cila i jep Ortakut të Vetëm të drejtën e pjesëmarrjes prej 100% (njëqind përqind) në kapitalin bazë të Shoqërisë.
- 6.2. Ortaku i Vetëm themelues zotëron kuotën e vetme të Shoqërisë të përcaktuar në nenin 6.1 më sipër.
- 6.3. Ortaku i vetëm themelues ka detyrimin të shlyejë kapitalin bazë të shoqërisë në tërësinë e tij, nga data e regjistrimit të shoqërisë.

NENI 7

Organet Drejtuese

- 7.1. Bazuar në dispozitat e ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 *“Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”* (i ndryshuar), organet drejtuese të Shoqërisë janë:



1. **Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve/Mbledhja e Ortakut të Vetëm**, e cila është organi më i lartë vendimmarrës;
 2. **Administratori**, i cili është organi ekzekutiv dhe administrativ i Shoqërisë.
- 7.2. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të tyre është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

NENI 8


Administrimi

- 8.1. Administratori i shoqërisë “WESTERN BALKANS UNIVERSITY DENTAL INSTITUTE” SHPK do të jetë Z. Ferdinand Gjana, shtetas Shqiptar, i biri i Agimit dhe Engjëllushes, i datëlindjes 25/08/1977, Shupenzë, Dibër dhe banues në TIRANË, me adresë Rrapo Hekali 03910112; Nd. 17; H. 4; Ap. 20; Farkë; Selitë; 1044; Tiranë, mbajtës i Letërnjoftimit ID nr. 034381265 dhe nr. personal H70825050O, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar.
- 8.2. Administratori emërohet për një afat 5 vjeçar, me të drejtë riemërimi, duke nisur ky afat nga data e regjistrimit të saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.
- 8.3. Shoqëria do të përfaqësohet përpara çdo organi administrativ, gjyqësor, apo çdo entiteti tjetër publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratori i shoqërisë (apo nga një ose disa persona të autorizuar prej saj), e cila i ushtron të drejtat dhe detyrimet e saj në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi.

NENI 9

Ligji i aplikueshëm

- 9.1. Veprimtaria e Shoqërisë rregullohet nga legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë, ky Akt Themelimi, si dhe parashikimet e Statutit të saj.



NENI 10

Regjistrimi

- 10.1. Shoqëria do të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit nga administratori dhe/ose një/disa person(a) të autorizuar prej saj për këtë qëllim, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

NENI 11

Dispozitat përfundimtare


- 11.1 Ky Akt Themelimi hartohet në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet nga ortaku i vetëm themelues i saj.

ORTAKU I VETËM THEMELUES

I

SHOQËRISË “WESTERN BALKANS UNIVERSITY DENTAL INSTITUTE” SHPK

Shoqëria “WESTERN BALKANS UNIVERSITY” SHPK



Administratori Z. Ferdinand GJANA